

VLERËSIMI TEMATIK



2020

VLERËSIMI TEMATIK I PAVARUR

GJYKATA E APELIT DURRËS AFATET E SHQYRTIMIT GJYQËSOR 2020

Realizuar nga:



Mbështetur nga:




**GJETJET E VLERESIMIT TEMATIK
VITI 2020**

GJYKATA E APELIT DURRËS

KOHËZGJATJA E SHQYRTIMIT GJYQËSOR, VITI 2020

Për vitin 2020, INFOÇIP mblodhi dhe analizoi 560 vendime për çështje themeli dhënë nga Gjykata e Apelit Durrës. Prej këtyre, 384 çështje themeli janë shqyrtuar nga Dhoma Civile, ndërkohë që 176 të tjera shqyrtuar nga Dhoma Penale. Totali vjetor, sipas regjistrave të gjykatës, është 562 çështje themeli.



Grafiku 1

Nga analizimi i të dhënave, rezulton se, gjatë vitit 2020, kohëzgjatja mesatare e shqyrtimit gjyqësor në Gjykatën e Apelit Durrës, për të dyja dhomat e marra së bashku ka qenë **388 ditë**. Kjo mesatare aplikohet vetëm mbi çështjet e themelit që janë vendimuar në vitin 2020. Vendimet e ndërmjetme dhe urdhrat e ekzekutimit nuk janë pjesë e këtij vlerësimi.

Të vlerësuara veç e veç, kohëzgjatja mesatare e shqyrtimit gjyqësor për **çështje civile themeli ka qenë 419.8 ditë** ndërkohë që kohëzgjatja mesatare e shqyrtimit gjyqësor për **çështjet penale themeli ka qenë 318.5 ditë**.



Grafiku 2

Tabela më poshtë paraqet në fasha kohore më të detajuara kohëzgjatjen e shqyrtimit gjyqësor (çështje themeli) në Gjykatën e Apelit Durrës. Për Dhomën Penale pjesa më e madhe rreth 22% e çështjeve janë shqyrtuar në fashën mbi 500 ditë. Ndërkohë për Dhomën Civile rezulton se, 43% e tyre, janë shqyrtuar në fashën mbi 500 ditë.


DHOMA PENALE, VITI 2020

Kohëzgjatja e shqyrtimit gjyqësor, 2020			
Nr.	Fasha kohore në ditë	Nr. Vendimesh	Shprehur në %
1	0-30 ditë	6	3%
2	31-60 ditë	8	5%
3	61-100 ditë	15	9%
4	101-200 ditë	38	21%
5	201-300 ditë	19	11%
6	301-400 ditë	29	16%
7	401-500 ditë	23	13%
8	Mbi 500 ditë	39	22%
Total		176	100.00 %


DHOMA CIVILE, VITI 2020

Kohëzgjatja e shqyrtimit gjyqësor, 2020			
Nr.	Fasha kohore në ditë	Nr. Vendimesh	Shprehur në %
1	0-30 ditë	8	2%
2	31-60 ditë	33	9%
3	61-100 ditë	17	4%
4	101-200 ditë	56	15%
5	201-300 ditë	40	10%
6	301-400 ditë	30	8%
7	401-500 ditë	35	9%
8	Mbi 500 ditë	165	43%
Total		384	100.00 %

FASHAT E SHQYRTIMIT




FASHAT E SHQYRTIMIT



Mesatarja e kohëzgjatjes së shqyrtimit gjyqësor të çështjeve të themelit në Gjykatën e Apelit Durrës rezulton të jetë **388 ditë**. Grafiku më poshtë ofron një vizualizim të posaçëm të performancës së dhomave në krahasim me mesataren e Gjykatës së Apelit Durrës në tërësi për çështjet e vendimuara prej saj në vitin 2020. Kohëzgjatja e shqyrtimit gjyqësor të çështjeve civile është rreth 32 ditë mbi mesataren e gjykatës, ndërkohë që ato penale shqyrtohen rreth 70 ditë më shpejt se mesatarja e gjykatës (vetëm çështje themeli).

Grafiku 3



ÇËSHTJET GJYQËSORE MË TË VONUARA, VITI 2020

INFOÇIP ka “filtruar” në një tabelë të posaçme **30 çështje penale themeli** që rezultojnë me **kohëzgjatjen më të madhe në shqyrtim**, vendimuar në 2020-ën nga Gjykata e Apelit Durrës. Me kohëzgjatje në shqyrtim nënkuptohet periudha nga regjistrimi i apelit deri në momentin e dhënies së vendimit. Tabelën e plotë me të gjitha çështjet e analizuarra për vitin 2020, renditura sipas vonesave e gjeni në: <https://www.gjkataehapur.al/vleresimi-i-kohezgjatjes-gjyqesore-ceshtje-penale-gjkata-e-apelit-durres-2020/>

NR. Vendimi	Data e Regjistrimit	Data e Vendimit	Kohëzgjatja në Shqyrtim (ditë)
161	28-Qer-18	27-Tet-20	852
174	12-krr-18	04-Nën-20	846
166	19-Sht-18	28-Tet-20	770
165	25-Sht-18	28-Tet-20	764
176	12-Nën-18	04-Nën-20	723
155	09-Nën-18	26-Tet-20	717
104	04-Sht-18	24-krr-20	689
84	18-krr-18	28-Maj-20	680
140	17-Dhj-18	12-Tet-20	665
135	17-Dhj-18	05-Tet-20	658
146	21-Jan-19	19-Tet-20	637
132	17-Jan-19	05-Tet-20	627
148	04-Shk-19	20-Tet-20	624
55	20-Qer-18	27-Shk-20	617
124	21-Jan-19	28-Sht-20	616
143	11-Shk-19	14-Tet-20	611
163	25-Shk-19	27-Tet-20	610
144	14-Shk-19	15-Tet-20	609
127	05-Shk-19	29-Sht-20	602
162	15-Mar-19	27-Tet-20	592
112	17-Dhj-18	30-krr-20	591
164	02-Pri-19	28-Tet-20	575
86	19-Nën-18	28-Maj-20	556
96	11-Dhj-18	18-Qer-20	555
97	11-Dhj-18	18-Qer-20	555
150	15-Pri-19	21-Tet-20	555
87	22-Nën-18	28-Maj-20	553
138	08-Pri-19	07-Tet-20	548
40	04-Sht-18	19-Shk-20	533
60	18-Sht-18	04-Mar-20	533

Në tabelën e mëposhtme janë të renditura **30 çështjet civile themeli** që rezultojnë të kenë **patur kohëzgjatjen më të madhe në shqyrtim** deri në marrjen e vendimit në 2020-ën në Gjykatën e Apelit Durrës. Tabelën e plotë të të gjitha çështjeve gjyqësore civile, të renditur sipas vonesave në shqyrtim e gjeni në: <https://www.gjykataehapur.al/vleresimi-i-kohezgjatjes-gjyqesore-ceshtje-civile-gjykata-e-apelit-durres-2020/>




NR. Vendimi	Data e Regjistrimit	Data e Vendimit	Kohëzgjatja në Shqyrtim (ditë)
300	05-Tet-17	24-Sht-20	1085
383	16-Jan-18	04-Nën-20	1023
304	08-Jan-18	29-Sht-20	995
286	07-Shk-18	21-Sht-20	957
277	14-Shk-18	09-Sht-20	938
371	04-Pri-18	28-Tet-20	938
244	20-Dhj-17	30-Qer-20	923
297	20-Mar-18	23-Sht-20	918
352	25-Pri-18	22-Tet-20	911
353	03-Maj-18	22-Tet-20	903
291	04-Pri-18	22-Sht-20	902
351	08-Maj-18	22-Tet-20	898
102	25-Sht-17	20-Shk-20	878
341	31-Maj-18	19-Tet-20	872
373	20-Qer-18	29-Tet-20	862
298	21-Maj-18	24-Sht-20	857
2	06-Sht-17	09-Jan-20	855
307	31-Maj-18	30-Sht-20	853
10	04-Tet-17	15-Jan-20	833
276	30-Maj-18	08-Sht-20	832
336	10-krr-18	15-Tet-20	828
335	16-krr-18	15-Tet-20	822
217	20-Mar-18	10-Qer-20	813
161	07-Shk-18	27-Pri-20	810
325	26-krr-18	13-Tet-20	810
253	08-Maj-18	23-krr-20	807
131	19-Dhj-17	03-Mar-20	805
29	13-Nën-17	23-Jan-20	801
162	28-Shk-18	07-Maj-20	799
227	06-Pri-18	22-Tet-20	930

KRAHASIMI I KOHËZGJATJES SË SHQYRTIMIT GJYQËSOR 2016-2020

Analiza e të dhënave sugjeron se ka një përkeqësim të treguesve në vitin 2020 sa i takon kohëzgjatjes së shqyrtimit të dosjeve gjyqësore. Rezulton se Gjykata e Apelit Durrës ka një përkeqësim me 22% në 2020-ën, krahasuar me 2019-ën. Ndërkohë në krahasim me vitin 2016 vihet re një përmirësim me 14.8% .

Nga të dhënat e analizuara, rezulton se në 2020-ën treguesit janë përkeqësuar me 17.8% për Dhomën Penale krahasuar me 2019-ën, ndërkohë në krahasim me vitin 2016 vihet re një përkeqësim me 2.6% sa i përket treguesit të kohëzgjatjes së shqyrtimit gjyqësor.

Sa i përket Dhomës Civile, ka një rënie me 22.8% në 2020-ën, krahasuar me vitin paraardhës. Ndërkohë, krahasuar me vitin 2016 vihet re një përkeqësim me 16.3% sa i përket këtij treguesi.



Të gjitha të dhënat e përdorura për krahasimin e treguesve vjetorë të kohëzgjatjes/vonesave, janë të aksesueshme e të verifikueshme në Platformën GJYKATAEHAPUR.AL, ne linkun: <https://www.gjykataehapur.al/gjykata-e-apelit-durres/>